

Besimi dhe Politika (Pjesa 1)

Fitojmë Kur Jemi NJË

Faleminderit që je bashkuar me festimin e kishës sonë.

Sot fillojmë një seri me 3 pjesë dhe me shumë gjasa mund të jetë seri e sikletshme për dikë.

E kam quajtur **Besimi dhe Politika**.

A shkojnë këto të dyja bashkë apo grinden me njëra-tjetrën?

Nuk kam bërë ndonjëherë seri të tilla në festimet e kishës, por ama kjo është gjë që po vlon dhe po zien kudo dhe na prek të gjithëve në një mënyrë apo në një tjetër. Dhe Bibla është e kohës për çdo lloj kohe dhe situatë ka mesazh.

E thënë troç që në fillim, politika sjell shumë ndarje, ka sjellë sherre, madje janë rrahur për shkak se disa kanë bindje politike të ndryshme dhe në raste të rralla, edhe janë vrarë njerëz për këtë gjë.

Me anë të kësaj serie uroj që do të ndodhin dy gjëra:

1 - Nuk do kemi asnjë lloj tensioni me njëri-tjetrin pavarësisht ngjyrave politike.

2 - Do jemi kripë dhe dritë aty ku jemi, do jemi model.

Në fakt, ekziston tension dhe frikë në këto momente.

Po çfarë merakuri kanë njerëzit?

Kemi merakun se do na hiqet dicka. Për shembull... Nëse ndërrohet qeveria, qeveria e re mund të na heqë nga puna. Nëse është e njëjta, mos bëhet më kontrolluese dhe më e egër, mund të na hiqen mundësi që na takojnë. Ka merak dhe frikë nga të dyja palët.

Kur takon mbështetës, i gjen të gjitha palët me bindje shumë të forta: “Ne do të fitojmë dhe pikë.” “Jo, do fitojmë ne dhe pikë.” Gati sa nuk kapen për fyti kur janë nëpër studio televizive.

Shokë, politika mund të sjellë shumë përçarje. Dhe lloj-lloj hamendësimesh do të dëgjosh këto kohë, që s’e dimë sa të vërteta janë: “Votat blihen,” “Jo, nuk blihen,” “Jo do të kushtojnë kaq, jo bëjnë aq.” Duket shumë e ulët që mund të ekzistojnë këto gjëra akoma edhe pas kaq shumë viteve.

Dhe ja ku jemi ne si kishë, jemi kisha e Krishtit. Jam shumë i sigurt që s’kemi të gjithë të njëjtat bindje politike. Por ama kemi një mundësi të artë që është:

Të kemi bindje politike të ndryshme por së pari ta duam njëri-tjetrin pa kushte.

A mund ta bëjmë këtë gjë? Po sikur t'i shikojmë gjërat së pari me filtrat e besimit, pastaj me sytë e politikës?

T'i shikojmë gjërat, t'iu japim rëndësi gjërave që iu dha Jezusi vetë rëndësi. Ai është modeli ynë kryesor.

Dhe Jezusi e dinte që këto gjëra do të vinin. Shiko, jo thjesht koha e zgjedhjeve. Por Ai e dinte që do vinin kohë që sjellin përçarje dhe ndasi.

Ku e gjejmë?

Natën që Jezusi hëngri darkë me 12 dishepujt, Jezusi u lut, dhe këtë lutje e gjejmë tek të 4-t ungjijtë: Mateu, Marku, Luka dhe Gjoni. Dhe në atë lutje ka dy gjëra të veçanta: Së pari, Jezusi nuk u lut vetëm për dishepujt por dhe për ne. Së dyti, Jezusi ka një kërkesë lutjeje.

Imagjino tani, ti je ulur me një grup njerëzish dhe mes jush është dhe Jezusi.

Dhe është ky moment: **Kush ka një kërkesë lutjeje?**

Jezusi ngre dorën dhe thotë: "Unë kam një kërkesë lutjeje."

Çfarë? Po, po, Jezusi ka një kërkesë lutjeje dhe është te ungjilli i Gjonit se çfarë i kërkoi Jezusi Atit.

Kush e di cila ishte kërkesa e Jezusit? Shiko sa e veçantë është: Para se të arrestohej, 10-12 orë para se të kryqëzohej, Jezusi ka një kërkesë lutjeje, te Gjoni 17.

Çfarë mund të jetë? "O Atë, lutem që gozhdat do të jenë të buta, që kamzhiku do jetë i butë, që gjembat e kurorës me ferra të jenë false, jo prej vërteti..."? A thua do lutet për këto? Le ta shikojmë:

Gjoni 17:1 *'Jezusi tha këto gjëra, pastaj i ngriti sytë drejt qiellit dhe tha: "O Atë, ora ka ardhur, përlëvdo Birin tënd, që edhe Biri yt të të përlëvdojë,'*

Gjoni 17:2 *'sepse ti i ke dhënë pushtet mbi çdo mish, që t'u japë jetë të përjetshme të gjithë atyre që ti ia ke dhënë.'*

Gjoni 17:3 *'Dhe kjo është jeta e përjetshme, të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar.'*

(E parafrazuar) "Atë, ora ka ardhur, pas 3 viteve e gjysmë duke shërbyer me këta djem, 12 dishepujt. Këtyre dhe botës ua kam thënë qartë se si je ti, si është mbretëria jote.

Por tani ka ardhur momenti i fundit. Përlëvdoje Birin tënd që për pak do të arrestohet dhe kryqëzohet.

Përlëvdoje, bëj të mundur që njerëzit ta dallojnë se kush jam, që kur të më njohin mua, të të njohin Ty.”

Dhe momenti kur Perëndia u përlëvdua më shumë ishte në momentin e errët të kryqëzimit.

Por Jezusi thotë që para se të vinte ky moment, kishte një kërkesë lutjeje. Është te vargu 11:

Gjoni 17:11 *'Tani unë nuk jam më në botë, por ata janë në botë, dhe unë po vij te ti. O Atë i shenjtë, i ruaj ata në emrin tënd, ata që më ke dhënë, që të jenë një sikurse ne!'*

(E parafrazuar) “Unë nuk do jem më në këtë botë, por dishepujt janë. Unë po vij tek ti, por këta janë në tokë akoma.”

Dhe këtë ka qenë duke iu thënë Jezusi herë pas here: “Unë do iki, unë do iki, kur të iki...”

Dhe Pjetri, i thoshte, “Po ku do të shkosh? Na e thuaj që të vijmë dhe ne.” Jezusi i tha, “Aty ku do të shkoj unë, tani për tani ju s’mund të vini.”

Po pjesa më e bukur, është pjesa e dytë e vargut 11:

“O Atë i shenjtë, i ruaj ata...” Cilët? 12 dishepujt.

“...i ruaj ata në emrin tënd, ata që më ke dhënë, **që të jenë një sikurse ne!**”

Fundi i fjalisë, përse të na ruajë Ati neve?

Cili është qëllimi i mbrojtjes nga Perëndia?

Dhe nuk po lutet për mbrojtje fizike, ai po lutet për diçka që Jezusi mendon se është më e rëndësishme.

“Ruaji që ata të jenë NJË o Atë, siç jemi unë dhe Ti.”

Kjo ishte kërkesa e lutjes që kishte Jezusi.

Ky ishte merak i Jezusit, merak i fundit, lutja e fundit e Jezusit, **uniteti, të jemi NJË**. Sepse ai e dinte frytin se çfarë do të ndodhte nëse ata do ishin Një.

E thotë te vargjet pak më poshtë, i njëjti kapitull.

Nëse jemi një bashkë, nëse jemi një bashkë me Atin, bota do të ndryshohet. Por nëse ndahemi, fuqia do të bjerë. Pastaj te vargu 20, aty Jezusi lutet për ty dhe për mua.

Gjoni 17:20 *'Tani unë nuk lutem vetëm për ta, por edhe për ata që do të besojnë në mua me anë të fjalës së tyre,'*

Jezusi tha, “Nuk lutem vetëm për këta të 12, lutem për brezat e tjerë të të krishterëve që do të vijnë.” Kjo është shumë e bukur, por ka dhe diçka që më trishton:

Sa herë i kërkojmë Atit, sa herë i lutemi Atit për gjërat që u lut vetë Jezusi?

Është e trishtë, sa pak lutemi në modelin e lutjes që ka bërë Jezusi vetë, dhe u lut në momentet e fundit të jetës së tij në tokë, që i bie ka qenë diçka shumë e rëndësishme, se është amaneti i fundit.

Shokë, ndoshta lutjet tona, si modeli i lutjes së Jezusit mund të sjellin ndikim të madh aty ku jemi.

E sigurt që po, “Zot, lutemi që ne të jemi në unitet, dhe lutemi për anëtarët e kësaj kisha, jo vetëm për ne, por edhe për ata që do të njohin Jezusin nëpërmjet nesh.”

Kjo është super lutje. Le të lutemi si Jezusi, lutemi për kishën ICF, lutemi për çdo anëtar, por edhe për ata që do njohin Jezusin nëpërmjet nesh. Qofshin socialistë, demokratë, LSI-stë, apo çfarëdo partie, çfarëdo origjine, shkollimi...

Kjo është lutje gjigande: të jemi një sikurse Biri dhe Ati janë një. Ne fitojmë, avancojmë mbretërinë e Perëndisë kur jemi NJË. Ta dëshirojmë këtë gjë, të lutemi për këtë gjë, të bëjmë pjesën tonë për këtë gjë, të mos lejojmë asgjë që të hyjë në mes, sepse është lutja e Jezusit. Dhe kjo nuk ndodh natyrshëm vetë, natyrshëm na vjen kështu: “Unë e di më mirë se ti, ti nuk di sa unë, unë jam më ndryshe nga ty, se jam blu, ti je lejla...” Natyrshëm na vjen të ndahemi e të përçahemi.

Prandaj Jezusi lutet: “Kisha do rritet Atë, do shkojnë cep më cep të botës, në gjuhë e kombe të ndryshme. Lutem që do jenë NJË. Dhe kjo për një arsye: për botën. Që kur bota të na shikojë që ne jemi një, bota do të njohë që ti më ke dërguar.”

Mënyra se si bota do besojë te Jezusi është kur të shikojë kishën e bashkuar, pavarësisht diversitetit, ndryshimeve, gjërat që s’biem dakort apo biem.

Kjo do të jetë mënyra se si do e kuptojë bota pagane se kush është Krishti: kur të shikojë se sa e bashkuar është kisha lokale. Do të shikojnë diçka që s’e kanë parë më parë. Jezusi iu tha: “Do t’ju jap një urdhërim të ri: **Ta doni njëri-tjetrin, sikurse unë iu kam dashur juve.**”

Nuk keni nevojë të sajoni ndonjë model, se si do e doni njëri-tjetrin. Thjesht shikoni modelin: “Siç ju kam dashur Unë, ashtu ta doni njëri-tjetrin.” Dhe nuk është sugjerim, është urdhërim.

Dhe përsëri del e njëjta gjë. Jezusi tha: “Dua që ta doni njëri-tjetrin, jo thjesht ‘xhan xhan’ me njëri-tjetrin, por me qëllim, që duke dashur njëri-tjetrin, bota do të njohë që ju jeni dishepujt e mi.” Për këto gjëra u lut Jezusi te Gjoni 17, dhe që

kjo dashuri të shpërndahej nëpër Jeruzalem, Jude, Samari edhe deri në Shqipëri, deri në fund të botës.

Dhe ky lloj uniteti nuk është unitet politik, por unitet me qëllim, që bota të njohë dashurinë e Perëndisë.

Dhe e di çfarë ndodhi pas ringjalljes së Jezusit?

Apostujt dolën në rrugët e Jeruzalemit me një qëllim: për të bërë dishepuj nga e gjithë bota. Dhe kishin një mesazh të vetëm: Jezusi është Shpëtimtari i botës. Dhe Ai u bë i tillë, duke vdekur në kryq dhe pas 3 ditësh Ati e ringjalli.

Ata dolën në rrugët e Jeruzalemit me një urdhërim të vetëm: Do ta duam njëri-tjetrin, siç e kemi parë Jezusin, siç na donte Ai ne.

Shokë, partia jote, kandidati yt mund të fitojë ose të humbasë, kjo do të varet se si do të votojnë shqiptarët ditën e zgjedhjeve.

Por ama, kisha do të fitojë ose do të humbasë në bazë të qëndrimit dhe sjelljes tënde ditë pas dite para kësaj bote që të shikon.

Duke të pare ty, duke na parë ne: si e trajtojmë njëri-tjetrin, si e duam njëri-tjetrin, a e duam njëri-tjetrin?

Prandaj Jezusi na nxiti që të mos lejojmë asgjë të na ndajë, të na përçajë, asgjë dhe asnjë. Këtë do e shikojmë me vëmendje në pjesën e tretë të serisë.

Miq, ishte Krishtërimi ai që i dha formë qytetërimit perëndimor. Parimet e krishtera u bënë parime në familje, në punë, në shoqëri. Ishte mesazhi i krishtërimin që i dha formë Europës dhe botës. Nuk ishin partitë, ishte krishtërimi. Ishin mësimet e Biblës, që bënë të mundur stabilizimin e vlerave morale, që krijuan ndjesitë e para të drejtësisë dhe dinjitetit njerëzor për çdo njeri. Sigurisht që ka patur gabime rrugës, sa të duash. Dhe akoma ka gabime, por shpresa e botës nuk është që të kemi një parti perfekte, shpresa është te mesazhi dhe mësimet e Jezusit që sollën vlerat shoqërore.

Dhe kur kjo gjë ka qenë ajo që i stabilizoi shoqëritë botërore, pse do lejojmë që të sjellin përçarje mes nesh?

Shokë, partitë shkojnë e vijnë. Sa drejtues e sa parti ka njohur ky vend, madje ishte një parti që gjasme ishte partia e popullit pas luftës së dytë botërore, partia e xhaxhit Enver që u mundua ta shkulte fare besimin te Perëndia në këtë vend. Po ku është xhaxhi Enver tani?

E parti të tjera, e ngjyra të tjera... do vijnë e do ikin, çdo 2 vjet ka zgjedhje.

Prandaj them, si mund të lejojmë ne, ndjekësit e Mbretit të Gjithësisë, të përçahemi nga bindjet e përkohshme të disa ngjyrave politike? Si mund të lejojmë ne që të përçahemi për shkak të frikës nëse fiton ose jo, njëra apo tjetra parti? Madje njeriu mund të ndryshojë bindjet politike. Sepse zgjedhjet e tjera mund të kenë të tjerë kandidatë, dhe një kushëri apo shok, apo dikush me integritet që ti e njeh, kandidon për partinë e kundërt që ti ke votuar gjithmonë dhe ti ndryshon bindjen politike.

Si mund të lejojmë që bindjet politike të na përçajnë diçka për të cilën Jezusi ka dhënë jetën?

Le të luftojmë për unitetin, për atë që u lut Mbreti ynë. Uniteti i tërhoqi vëmendjen botës pagane, mbretërive. Ky është vullneti i Perëndisë: uniteti ynë.

Kështu që, a do të lutemi siç u lut Jezusi?

Sepse shumë prej nesh, mund të mos jenë lutur kurrë siç u lut Jezusi. A do të lutemi që të jemi NJË?

A do lutemi kështu? A të ta jap një model, që të mund të lutesh këtë javë:

“O Atë, na bëj një, që të ndikojmë sa më shumë.”

Nëse jemi NJË, ne fitojmë, sepse bota do të shikojë dhe do i tërheqë vëmendjen kjo gjë.

Qoftë kjo lutje, lutja jote gjithë javës: **“O Atë, na bëj një, që të ndikojmë sa më shumë.”**

Kjo ishte lutja e Jezusit, pak orë para se të vdiste në kryq. Prandaj Ai u lut për mbrojtjen tonë, që të ndikojmë botën. Eja lutemi bashkë me këtë lutje. A e themi me një zë, në kor? Aty ku je?

Gjëja e dytë që dua të bëni këtë javë, është se dua që të kërkoni për mundësi për të dashur dikë pa kushte. Ndoshta ndonjëri thotë, “Po unë kështu jam gjithmonë.”

Mirë, mirë, po këtë javë ji me synim.

Duaj dikë pa kushte. Dikë që është me partinë tjetër, dikush që ka bindje politike të ndryshme nga ti.

Ndoshta ndonjëri mund të thotë: “Po unë nuk i kam as shokë ata që janë me bindje të ndryshme politike.”

Atëherë paske punë këtë javë, për t’i gjetur.

Pra, do lutemi, “O Atë, **na bëj një që të ndikojmë sa më shumë,**” dhe do të kërkojmë për mundësi, **se si të duam dikë,** të bëjmë për dikë që është me bindje të ndryshme politike nga ne.

Nëse ti njeh Krishtin, ti je dritë dhe kripë në komunitetin tënd.

Ndoshta ndonjëri mund të thotë, “Po çfarë ndikimi mund të sjellë kjo?” Ja, kaq sa jemi ne, do ndikojmë nga një apo disa persona. Ndoshta dikush mund edhe të mendojë: “Sa naiv është ky pastori, me një grup të vogël njerëzish, pretendon të ndikojë. Apo kështu naivë janë të gjithë pastorët, po kaq naivë.”

Mund të duket shumë naive, por imagjino dhe këtë: Imagjino Jezusin, diku te 33 vjeç dhe është me 12 djem më të rinj se vetja, ndoshta ishin adoleshentë, ndoshta tek të 20-tat apo pak më të rritur.

Dhe ata nuk ia kanë haberin nga politika, as nga bota. Janë aty dhe është vapë e madhe se janë në lindjen e mesme, ndoshta nën hijen e ndonjë fiku.

Dhe ky Jezusi iu thotë: “*Djema, unë do të ndërtoj kishën time, që do të jetë një lëvizje, një grupim i madh në gjithë botën.*” Në këtë kohë ishte ilegale që të mblidhje shumë njerëz, kështu ishin rregullat e Perandorisë Romake, nuk lejoheshin grupime të mëdha të mblidheshin bashkë. Dhe Jezusi thotë: “**Unë do ta ndërtoj kishën time dhe dyert e Ferrit nuk do ta mundin atë.**”

Kjo duket shumë naive, në pamje të parë. Djemtë do kenë parë vërdallë, “Me cilin e ke Jezus, me ne, ne do jemi pjesë e kësaj? Po si? Ne do ikim nëpër botë? Unë deri te marketi lagjes kam qenë.”

Ajo që premtoi të ndërtonte Jezusi, do ishte më e fortë se tempulli, më e fortë se kultura, më e fortë se Perandoria Romake, më e fortë se çdo gjë.

Ta besojë këtë ishte super naivitet.

Por ama Jezusi e bëri, dhe pjesë e kësaj kishe universale jemi ti dhe unë. DHE çelësi i rritjes së kishës së tij, kishë që ka vazhduar dhe do të vazhdojë brez pas brezi, është nëse ne jemi NJË.

Le të mos biem dakort politikisht, le të votojmë cilin kandidat dhe parti që të duam ditën e zgjedhjeve, POR ama le të lutemi për unitet, që të jemi një dhe ta duam pa kushte njëri-tjetrin dhe këdo.

Javën tjetër kemi pjesën e dytë të kësaj serie.

Le të lutemi.